



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE**

**Raport
Veprimtaria e Komitetit Shqiptar te Biresimeve
Shtator 2021 - Shtator 2022**

Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB) është themeluar në vitin 1993 me miratim të Ligjit nr.7650, datë 17.12.1992 “Për Birësimet e të Miturve nga Shtetas të Huaj dhe për Disa Ndryshime në Kodin e Familjes”. KSHB është i vetmi Autoritet Qëndror përgjegjës për realizimin e birësimeve në Shqipëri. Birësimet janë tre llojesh: Biresim vendas, birësim ndërvendas dhe birësim me pëlqim. Në çdo rast misioni i KSHB- së mbetet gjetja dhe vendosja në një familje të përshtatshme e çdo fëmijë të deklaruar të braktisur duke garantuar interesin më të lartë të fëmijes.

Funksionet e saj KSHB i kryen përmes:

- Sistemit të fëmijëve të braktisur në familje të reja dhe të përshtatshme për një rritje sa më normale të fëmijës;
- monitorimit të ecurisë pasbirësuese;
- ofrimit të një shërbimi cilësor në përputhje me legjislacionin në fuqi për çdo të interesuar;
- pjesëmarrjes në seanca gjyqësore me objekt “Birësim Fëmijë”;
- përgatitjes së dokumentacionit përkatës për finalizimin me sukses të birësimeve vendase, ndërvendase dhe me pëlqim;
- bashkëpunimit me Agjensite e huaja në fushën e birësimit dhe Autoritetet Qendrore përkatëse në përputhje me legjislacionin e Konventës së Hages;
- bashkëpunimit me Institucionet e Përkujdesit Social dhe monitorimin e tyre sidomos lidhur me interesimin e shfaqur nga familjet biologjike.

Gjatë periudhës Shtator 2021- Shtator 2022, Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka vijuar intensivisht punën për të finalizuar me sukses të gjitha rastet e birësimit në proces dhe vendosjen e fëmijëve në familjet përkatëse. Në këtë periudhë pranë KSHB :

Janë regjistruar **33 dosje fëmijësh** prej të cilëve **29** fëmijë kanë ardhur nga shtepite e foshnjes dhe **4** fëmijë nga familjet.

Nga fëmijët e ardhur, **20** janë birësuar dhe janë vendosur fizikisht në familje, **10** janë në procedurë atashimi me prinderit birësues apo gjatë proceseve gjyqësore, dhe për **3** prej tyre

jemi ende në kërkim të një familje te pershtatshme, pasi janë femije me problematika shendetesore.

Në total per periudhën Shtator 2021- Shtator 2022 janë kryer me sukses **37 biresime**:
24 biresime vendase (21 fëmijë të ardhur nga shtepite e foshnjes dhe 3 nga familja),
13 biresime ndërvendase, (12 fëmijë nga shtepite e foshnjes dhe 1 fëmijë nga familja).

Në gjithë biresimet e realizuara kemi patur vetëm **3 raste** revokim biresimi, te ndodhura për arsye objektive, në pamundësi për tu realizuar atashimi prind biresues – fëmijë.

Vlen të theksohen se përveç fëmijëve të ardhur gjatë këtij viti, KSHB ka bërë përpjekje për të sistemuar fëmijë që kanë qenë të regjistruar prej vitesh në listën e pritjes së KSHB. Është bërë punë intensive për gjetjen e familjeve për këta fëmijë dhe si rezultat janë biresuar **4** prej tyre. Këto biresime konsiderohen raste suksesi, për shkak se fëmijët paraqesin problematika të rënda shëndetësore si dhe moshë mesatare 10 vjeç, moshë që përgjithesisht e bën shumë të vështirë, pothuaj te pamundur biresimin nga një familje.

Te dhena krahasuese me një vit më parë:

Numri i biresimeve vendase është dyfishuar krahasuar me periudhën e një viti më parë, Shtator 2020- Shtator 2021,

Një vit më parë janë realizuar :

12 biresime vendase (5 fëmijë nga shtëpitë e foshnjës dhe 7 nga familje),

13 biresime ndërvendase, (11 fëmijë nga shtëpitë e foshnjës dhe 2 fëmijë nga familje).

- Përveç një numri në rritje të interesimeve për biresim me kërkesa në rrugë elektronike, shpresore dhe paraqitjes në zyrë, në KSHB gjatë kësaj periudhe janë dorëzuar fizikisht nga aplikantë vendas **30 dosje** për biresim. Të gjitha dosjet janë shqyrtuar dhe **28** aplikantë (bashkëshortë dhe të vetëm), janë trajnuar në 4 seancat këshillimore dhe kanë kryer gjithë procedurat duke u vendosur në listë pritje për biresim pas marrjes së “Vendimit të Përshtatshmërisë”. Vetëm për **2** aplikantë kërkesa nuk është pranuar.
- Nderkohe janë regjistruar :
- **17** dosje për biresim nga aplikantë të huaj, të ardhura nëpërmjet Agjencive dhe Autoriteteve të huaja. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (ishin regjistruar **9** dosje), numri i dosjeve të huaja kete vit është dyfishuar. (**17 dosje**)

Ndërkohë, vitin e kaluar janë dorëzuar **36** kërkesa, dhe vetëm **1 kerkese** nuk është pranuar. Me shqyrtimin e kërkesave KSHB ka vijuar në periudhën e mëvonshme.

Gjithashtu, kërkesat e depozituara ne KSHB për biresim me pëlqim janë finalizuar me sukses brenda një kohe të shkurtër në më pak se 3 javë, nga dorëzimi i dokumentacionit deri në : “Dhënien e pëlqimit për Biresim” nga KSHB.

Krahasuar me vitet e kaluara ka marrë nje vëmendje të posacme “Ndjekja e ecurisë pasbiresuese”. Është punuar intesivisht për të zhvilluar takimet brenda afateve të përcaktuara per biresimet e kryera, duke mos lene menjane raportet pasbiresuese të pa kryera ndër vite. Në

pjesën më të madhe të rasteve, ecuria pasbirësuese është monitoruar me vizita në familjet biresuese.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar monitorime periodike në Institucionet e Përkujdesit Social (Shtëpitë e Foshnjës). Këto vizita kanë sjellë realisht një rritje të bashkëpunimit dhe sidomos shkurtimin e kohës që këto institucione zakonisht marrin për të përcjelle në KSHB dosjet e fëmijëve të deklaruar të braktisur nga gjykata.

Problematika

Nga kontrollet e kryera konstatojmë se mbetet ende shqetësues fenomeni i zvarritjes së përcjelljes në KSHB të dosjeve të fëmijëve të braktisur nga Shtëpite e Foshnjës. Këto institucione i zvarrisin proceset nga frika e mbylljes së tyre për shkak të shkurtimit të numrit të fëmijëve, fakt shumë i rëndë ky për tu pranuar, por fatkeqësisht i vërtetë.

Problem tjetër shqetësues mbeten proceset gjyqësore. Konstatojmë në vazhdimësi zvarritje pa fund të proceseve gjyqësore, ndonjëherë për shkak të mos kuptimit të rëndësisë që ka faktori kohë për fëmijet – si faktor që ndikon drejtpërdrejt në mirëqënien e tyre, pasi sa më parë të sistemohet fëmija në familje aq më mirë do të jetë për të. Në raste të tjera zvarritja vjen edhe si pasojë e numrit të pakët të gjyqtarëve të mbetur në detyrë pas procesit të vetingut. Për të ndihmuar këto procese është angazhuar personalisht Ministri i Drejtësisë përmes takimeve të posacme me KLGJ, takime ku janë sqaruar përparsitë që proceset e birësimit duhet të kenë në raport me rastet e tjera të proceseve gjyqësore familjare.

Ndërkohë janë zhvilluar edhe takime të kryetares së KSHB me disa përfaqësues të lartë të gjykatave nëpër rrethe. Mund të thuhet se ka disa përmirësime në raste të veçanta, por ka ende shumë punë për të bërë.

Një problem për tu marre në konsiderate është edhe nevoja imediate që KSHB ka për miratimin në Kuvend të ndryshimeve ligjore të propozuara, ndryshime që pritet të ndikojnë pozitivisht në procedurat e birësimit duke vënë në qëndër interesin më të lartë të fëmijës.

Sfide tjetër ka qënë plotësimi i stafit me specialistë dhe organizimi i punëve dytësore, sfidë e cila është kaluar me sukses , por gjykojmë se KSHB ka nevojë për staf shtesë të kualifikuar, specialiste psikologe dhe punonjës sociale dhe juriste. Numri i kërkesave për birësim po rritet ndjeshëm dhe procesimi i kërkesave kërkon burime njerëzore shtesë , pasi me këto kapacitete njerëzore që aktualisht disponon KSHB nuk arrin të garantojë cilësinë e dëshiruar.

Me respekt,

Alma Sulstarova Laci

Kryetare e KSHB